

Procesverbal

*Nga Mbledhja V (e pestë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
02.06.2025*

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Propozim-vendim për miratimin e nismës për bashkëpunimin komunal ndërkombëtar dhe fillimin e procedurave për binjakëzimin ndërmjet Komunës së Dragashit dhe Komunës Purkesdorf - Austri;
3. Propozim-vendim për miratimin e nismës për bashkëpunimin komunal ndërkombëtar dhe fillimin e procedurave për binjakëzimin ndërmjet Komunës së Dragashit dhe Komunës së Mavrovës - Rostushës, Maqedoni e Veriut;
4. Propozim-vendim për anulimin e Vendimit për publikimin e listave të pronave të paluajtshme të Komunës (Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë) 01Nr.060/01-5357-3/25 të datës 08.04.2025; dhe
5. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, kolegë asambleistë, OSBE, media dhe ju të pranishëm! Mirë se keni ardhë në seancën e pesët të rregullt për vitin 2025! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë, ku i kemi katër pika të rendit të ditës dhe pikën eventuale. Nëse dikush dëshiron me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

Driton Ademi: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë! Kryesuese, me sa e pashë mbrëmë ka ardhë një email shumë vonë, afër orës 12. Unë besoj që është shumë i parëndësishëm ai email, në krahasim me ditën e sotit, ne si Asamble që e kemi Kuvendin. Edhe sot, ndoshta ju doni me e shfrytëzue rastin mos me e mbajt seancën deri në fund për me shkue në ora 12:00 për festën. Unë besoj që ne duhet me e mbajt seancën, e festën ata munden me e shty – ose u dashtë me u koordine me kohë për datat e mbajtjes së seancës, në bashkëpunim me shkollën. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë, para se me e qit në votim rendin e ditës, këtu kemi edhe mysafirë. E kemi kryetaren e Asamblesë Komonale të Fëmijëve, bashkë me anëtarësinë, të cilëve u urojmë mirëseardhje dhe të kalojnë mirë sot në këtë seancë. Driton, e dini që para 7 ditëve ka qenë ftesa ime për në Asamble. Ku është problemi, duhet

organet e larta me e qit pse u bë sot në ora 12:00 ai manifestim. Përndryshe, para 7 ditëve nuk ka qenë ajo, kjo ka qenë thirrja ime e parë. Për çfarë arsye bëhen, nuk jemi në dijeni. Nedžmidin, vetëm nëse e kem për rendin e ditës. Nëse prapë vazhdosh për këtë punë, jo! Vetëm për rend të ditës! Ty Nexho të kemi thirrë në seancë, në seancë ke me ndejt. Atëherë, po e qesim në votim. Kush është pro rendit të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 19 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën rreth pikës së parë? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro procesverbalit nga mbledhja e kaluar? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe pikën e parë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Propozim-vendim për miratimin e nismës për bashkëpunimin komunal ndërkombëtar dhe fillimin e procedurave për binjakëzimin ndërmjet Komunës së Dragashit dhe Komunës Purkersdorf – Austri. A dikush rreth kësaj pike me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve. Më vjen mirë që kemi përpara një iniciativë të tillë, përkatësisht një kërkesë të tillë, për miratimin e procedurës për bashkëpunim ndërkomunal ndërkombëtar, respektivisht për binjakëzimin me komunën e Purkersdorfit, e cila ndodhet në Austri. Ajo që do të kemi si përfitim nga ky binjakëzim është zhvillimi ekonomik, pastaj një praktikë e re e zbatuar në komunën e tyre – e cila ka të bëjë me instalimin e paneleve diellore, si dhe kujdesi ndaj personave më të moshuar. Të gjithë e dimë, jemi dëshmitarë se popullsia jonë po bëhet gjithnjë e më e moshuar. Komuna e Purkersdorfit dhe kryetari i saj kanë marrë mbështetje në zgjedhjet e fundit në Austri pikërisht për iniciativa të tilla, si dhe për kursimin e energjisë elektrike. Ajo që do të doja të propozoja është që në këtë kërkesë, në preambulën e kërkesës, ku thirret kryetarin në bazë të nenit 18 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, nëse e shikojmë nenin 18, ai flet për atë që duhet të bëjë Kuvendi, ndërsa kryetari si organi i parë i pushtetit ekzekutiv ka të drejtë të iniciojë këtë iniciativë, por në përputhje me nenin 6 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, si dhe nenin 5 të Rregullores për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërkomunal. Pra, propozimi im është që neni 18 të zëvendësohet me nenin 6, dhe neni 6 me nenin 5, dhe në këtë mënyrë kjo kërkesë do të ketë formë më të fortë juridike dhe bazë të saktë ligjore. Ju faleminderit.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv.kryesues! Të nderuar delegatë, të nderuar asambleistë të ri! Ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në takimin në të cilin do të keni rast

nga afër të përcillni punën e Asamblesë Komunalë të Dragashit. Siç e dini, vitin e kaluar Komuna e Dragashit e ka themeluar Asamblenë e Fëmijëve, kurse sot, për nder të 1 Qershorit – është përrputh edhe data e mbajtjes së Asamblesë – kështu që këta janë ftuar sot të marrin pjesë në këtë takim dhe ta përcjellin punën e Asamblesë Komunale. Sa i përket propozimit të z.Munir, sa i përket binjakëzimit të Komunës së Dragashit dhe dhe Komunës Purkesdorf të Austrisë, propozimet që i ka dhënë Muniri janë procedura ligjore të cilat Zyra Ligjore e Kuvendit Komunal do t’i marrë parasysh në rastin e shtypjes së vendimit. Ndërsa, sa i përket votimit tuaj për binjakëzimin, siç e dini, para disa kohe asambleistët, një delegacion i Komunës sonë e ka vizitue Austrinë, me ç’rast, unë si kryetar i Komunës, bashkë me kryesuesen edhe një përfaqësues të opozitës, e kemi vizitue Komunën e Purkesdorfit, me ç’rast jemi takuar edhe me kryetarin e Komunës i cili në ka bërë një pritje jashtëzakonisht të ngrohtë. Në mes tjerash, të dy kryetarët kemi bisedue, kemi dhënë informata për komunat tona. Në fund jemi marrë vesh – ne kemi paraqitë kërkesën që Komuna jonë ka dëshirë që të binjakëzohet me Komunën Purkesdorf të Austrisë. Arsyeja është sepse shumë qytetarë të Komunës së Dragashit punojnë në këtë komunë, dhe kemi pasur informata nga këta qytetarë se kjo është një komunë e cila i trajton jashtëzakonisht mirë qytetarët tanë. Fushat në të cilat ne mund të bashkëpunojmë përfshijnë aspektin ekonomik, kulturës dhe të personave me nevoja të veçanta. Kryetari i asaj komune na ka premtue se kërkesën tonë ata do ta shqyrtojnë me kujdes dhe – gjithashtu, edhe ata e kishin rregulloren që Asambleja e tyre duhet ta shqyrtojnë, duhet ta marrin një vendim. Mirëpo, ne kemi vendosur që ta bëjmë hapin e parë, dhe sot, në këtë mbledhje, ne ta biem një vendim që Komuna e Dragashit është e interesuar që me Komunën e Purkesdorfit të bëjë këtë binjakëzim. Prandaj është në dorën tuaj që të përcaktoheni për këtë propozim apo këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Z.Munir deshti që Neni 18 të kthehet në Nenin 6 dhe Neni 6 në 18, ashtu siç e kuptova në përkthim. Por, vendimi është me bazë e rregullime dhe kërkesa me nen është mirë, por, siç e tha edhe kryetari, kërkesat le t’i shkojnë zyrtarit ligjor edhe besoj që munden me u lëviz këto. A e lëmë kështu, Munir?

Munir Jonuzi: Faleminderit. Para jush është ligji, dhe ju, në bazë të asaj që do të lexoni nga neni 5, do ta kuptoni që ne këtu po shqyrtojmë kërkesën e z. Kryetarit. Në nenin 5 thuhet qartë se ai ka të drejtë të iniciojë një kërkesë, përkatësisht një bashkëpunim ndërkombëtar dhe

ndërkomunal. Nëse ne e lëmë nenin 18 dhe nenin 6, siç qëndrojnë në atë kërkesë, atëherë mendoj se do të bëjmë gabim, sepse ajo është diçka që duhet ta bëjmë ne si Kuvend. Shikoni si është shkruar në vendim – aty thuhet: “Në bazë të këtyre ligjeve kam nderin t’jua paraqes këtë kërkesë.” Por në bazë të këtyre ligjeve që janë përmendur aty, atëherë, z. Kryetar, ju nuk e keni këtë nder. Ndërsa në bazë të nenit 6 të Ligjit tonë për Bashkëpunim Ndërkomunal, si dhe në bazë të Udhëzimit, përkatësisht Rregullores për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërkomunal – neni 5 thotë qartë se ju e keni këtë nder. Duhet vetëm të rregullohet kjo. Natyrisht, nuk kam asgjë kundër binjakëzimit, e kam thënë se komuna jonë mund ta ndjekë shembullin e komunës Purkersdorf, e cila në shumë aspekte ka treguar efikasitet – nga kursimi i energjisë elektrike deri te modernizimi i ndriçimit publik. Ata e kanë zëvendësuar të gjithë ndriçimin publik me llamba LED dhe në këtë mënyrë kanë arritur një kursim prej 30% të mjeteve buxhetore.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, e hedhim në votim. Kush është pro, me krkesat që i bëri z.Munir, që të ndryshohen këto nenet. Kush është pro që të miratohet kjo pikë? A ka kundër? Abstenim? Me 21 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e dytë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Propozim-vendim për miratimin e nismës për bashkëpunimin komunal ndërkombëtar dhe fillimin e procedurave për binjakëzimin ndërmjet Komunës së Dragashit dhe Komunës së Mavrovës - Rostushës, Maqedoni e Veriut. A do dikush me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, edhe kjo është një pikë sikur ajo që e miratuat. Unë si kryetar i Komunës që dy herë, me kërkesë të kryetarit të Komunës Mavrovë-Rostushë, z.Medat Kurtovskit, kam vizituar këtë komunë, bashkë me një delegacion. Ka më pak se një muaj kur e kemi vizituar herën e fundit këtë komunë, dhe një prej temave që është diskutue ka qenë edhe binjakëzimi i komunave. Ekzistojnë shumë arsye pse edhe ne edhe Kryetari Medat është pajtue. Arsyja është edhe gjeografike, edhe përbërja e popullsisë – është komunë multietnike, është komunë kufitare, është komuna e cila mbi 90% të territorit e ka të shpallur park nacional. Ajo që na lidh më së shumti është bashkëpunimi ndërkufitar mes Komunës tonë dhe asaj të Mavrovë-Rostushës. Nëse ne bëjmë binjakëzimin, ata do ta kenë shumë më lehtë ta çojnë përpara projektin e ndërtimit dhe asfaltimit të rrugës e cila e lidh Mavrovë-Rostushën me Komunën tonë. Është një rrugë e cila u shërben të dy komunave, do të bëhet një komunikim shumë më i lehtë edhe i njerëzve,

edhe i mallrave, edhe i zhvillimit të turizmit. Andaj, dua të ju njoftoj se Komuna Mavrovë-Rostushë para dhjetë ditëve e ka miratue, Asambleja e tyre e ka miratue vendimin dhe e ka miratue kërkesën për binjakëzim. Kështu që, i kisha lut delegatët që me ngritje dore të deklarohen për këtë kërkesë apo këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit! Rruga jonë është e çuar deri te kufiri me asfalt, rruga e tyre është e kalueshme vetëm me xhipa, jo me kerra luksozë. Ne, kur kemi qenë vitin e kaluar, kemi bërë kërkesën që kjo rrugë të ndërtohet. Kështu që, me kërkesën tonë – pastaj e kemi pas një takim edhe me drejtorin e Rrugëve në Shkup, dhe kjo kërkesë është miratue edhe është shpallë tenderi për hartimin e projektit. Tenderin e ka marrë një kompani dhe brenda muajit do të hartohet projekti. Sigurisht që kjo rrugë do të jetë e kualitetit pak më të lartë. Pas hartimit të projektit, atëherë duhet të shpallet tenderi për ndërtimin e kësaj rruge. Kështu që, arsyeja pse i kemi bërë këto vizita është edhe kjo rrugë, edhe lidhja e Komunës sonë përmes rrugës së asfaltuar me Komunën e Mavrovë-Rostushës, kështu që ne do të fitojmë edhe në kohë – ne nuk shkojmë më kah Shkupi, po mund ta përdorim këtë rrugë. Prej kufirit deri në Mavrovë është 20 km. Trashësia e asfaltit tonë është 8-10 cm.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro këtij Propozim-vendimi? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero zbstenim, e miratojmë edhe pikën e tretë. Vazhdojmë me pikën e katërt: Propozim-vendim për anulimin e Vendimit për publikimin e listave të pronave të paluajtshme të Komunës (Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë) 01Nr.060/01-5357-3/25 të datës 08.04.2025. A do dikush me e marrë fjalën?

Shpetim Hajredini: Përshëndetje i nderuar ekzekutiv, kolegë/kolege asambleistë, qytetarë të nderuar të Dragashit! Unë nuk do të ndalem shumë të diskutoj për këtë çështje, por do të mundohem dhe do ta lexoj në shpejtësi vetëm arsyetimin e Ministrisë për kthimin e këtij Vendimi të cilin e kemi marrë na në seancën e kaluar, po më duket. Dhe, të më jepe përgjigje drejtori pse ka ndodhë ky kthim nga ana e MAPL-së, kur arsyetimin këtë e kanë shumë të qartë. Arsyetimi i cili na ka ardhë nga ana i Ministrisë thotë kështu: “Kuvendi i Komunës së Dragashit, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.04.2025, ka miratuar Vendimin 01Nr.060/01-5337-3/25 ...”, ku MAPL konsideron se “Vendimi i nxjerrë nga KK i Dragashit është në kundërshtim me Nenin 13, Paragrafi 1 të Ligjit 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të

Komunës që përcakton se: 1) Komuna duhet të publikojë Listën e Përgjithshme të Pronave të Paluajtshme të Komunës, si dhe Listën e Veçantë të Pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri më 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës”. Arsyetim i kuptueshëm, i kapshëm, besoj që të gjithë – nëse e kanë lexue – e kanë kuptue se çfarë lëshimi është bërë nga ana jonë. Edhe nga ana ime personalisht po them, se nuk e kam lexue këtë ligj që me e ditë, përndrysh nuk do ta kisha votue e as nuk do ta kisha diskutue në seancën e majit. Kjo është për të ardhur keq, për mu personalisht – po e marrë përgjegjësinë për vete – pse nuk kam hy edhe me lexue, por kam besue që nuk bëni një lëshim të tillë. “Kuvendi i Komunës së Dragashit, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.04.2025, ka miratuar Vendimin 01Nr.060/01-5337-3/25 për publikimin e listave të pronave të paluajtshme të Komunës (Listës së Përgjithshme dhe Lista e Veçantë) dhe MAPL ka konfirmuar Vendimin në fjalë. Andaj, bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Dragashit duhet të ndërmarrë veprime dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditëve të rishqyrtojë dhe të harmonizojë aktin me legjislacionin në fuqi.” I nderuar drejtor, e bëna këtë lexim për hir të transparencës së qytetarëve dhe ndaj atyre asambleistëve të cilët nuk e kanë lexue arsyetimin e Ministrisë. Deshta me e marrë një përgjigje nga ana juaj. Pse, drejtor, na keni sjellë prapë në seancën e majit që ta votojmë edhe një herë, kur e keni ditë që ligji nuk e lejon një gjë të tillë? Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Përshëndejte kryetar, kryesuese dhe delegatë të pranishëm, zëvendëskryesues! Sa i përket pyetjes që është parashtruar, asgjë kontestuese nuk ka. Ligji për Dhënien në Shfrytëzim të Pronave Komunale është në rishqyrtim e sipër dhe ka vakume të ndryshme ligjore që nuk janë paraparë, dhe e ka kalue draftin, pritet që në një seancë tjetër të Kuvendit të Kosovës kur të miratohet që të dalë në votim, edhe mund të miratohet me ndryshime. Njëri prej ndryshimeve është që të rishikohen brenda dy viteve – se ma herët ka qenë brenda një viti dy herë mund të rishqyrtohen pronat e përgjithshme dhe pronat e veçanta të cilat janë për me u dhënë në shfrytëzim. Në ligjin e fundit të vitit 2019, kjo nuk parashihet dhe është e tillë qysh e lexuat edhe ju, i nderuar delegat, dhe është shumë normale. Mirëpo, gjatë punës praktikisht janë paraqit disa kërkesa të qytetarëve, të cilat mund të jenë në kontest dhe marrin vendime gjyqësore që mund të jenë edhe pjesë e kësaj Liste, por për shkaqe se në një afat të duhur kohor janë në një procedurë, nuk mund të jenë. Gjithashtu, kemi edhe prona të cilat i kemi si tërësi me një numër të parcelës, kemi nevojë t’i ndajmë, t’i parcializojmë dhe pastaj të mund t’i qesim në dhënie në shfrytëzim. Këto probleme

teknike, që asgjë nuk vështirësojnë, vetëm se e përshpejtojnë procesin, kemi mendue se mund t'i bëjmë. Këtë jau kemi pru juve si delegatë që ne të kryejmë një obligim tonin si qytetarë që jemi, për kërkesat kur na paraqiten dhe u mundësojmë qytetarëve që të realizojnë interesat e tyre. Në qoftë se Qeveria e sheh të arsyeshme që nuk është e ligjshme dhe për momentin nuk mund të kalojë, na ka kthye prapë dhe asgjë e keqe nuk është bo. Ne gjithashtu e kemi miratue në seancën e fundit të gjitha pronat e përgjithshme edhe pronat e veçanta për Komunën. Kjo ka qenë një aneks që nuk ka mund Sektori i Gjeodezisë që ta bëjë ndarjen me kohë, që t'i bashkëngjitet kësaj Liste, ka ardhë me vonesë, ia kemi bashkëngjijt kësaj Liste, kemi kërkuë nga Qeveria të na miratohet, nuk na është miratue, dhe normalisht ne këtij vendimi do t'i përgjigjemi në të njëjtën mënyrë, në qoftë se nuk e ekzekutojnë më tutje. Mbetet valide Lista e cila është miratue në seancën e fundit të vitit të kaluar për shfryëzim gjatë këtij vitit. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Kush është pro anulimit të këtij Vendimi? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e fundit, pikën eventuale.

Pajtesa Berisha: Përshendetje, të nderuar kolegë, përshëndetje kryetar dhe ju media! Kam një kërkesë nga banorët e fshatit Buqe; që të krijohet një kod për me e shti në Buxhet ndriçimin e fshatit. Gjithashtu, edhe për fshatin Zym është urgjente që prej rrugës kryesore – rrugës që nisesh përpjetë – ndërrimi i pllakave, se janë shumë të lëmuara dhe shumë të dëmtuara, ka një kohë. Dhe, rrugën përmbi xhami, me ndërtimin e murit, pas kubëzimit ato kanë rrëshqit. Kështu që, është bërë rruga vetëm me xhipa e me traktorë me kalue, se është e pakalueshme. Ju faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Në seancën e kaluar, superdrejtori i Shëndetësisë nga kjo foltore mua më tha që jam rrenacak edhe njeri i poshtër, sepse po e akuzoj që në periudhën në vitin 2021 dhe 2022, i ka blerë 5 vetura për Ndhimën e Parë. Sipas dokumentave që unë kam marrë si material për seancën këtu, sipas Raportit të tij, Raporti në vitin 2022 shkruan që ai i paska blerë 3 vetura të Ndhimës së Parë. Raporti i vitit 2022 po shkruan që ai i ka blerë edhe dy vetura. Sipas raporteve financiare – kodi 31703 – për vitin 2021 shkruan që janë shpenzuar 104,789.20€. Dhe, sipas Raportit Financiar për vitin 2022 – kodi i njëjtë 31703 – po shkruan që janë shpenzuar 80,440.00€ për blerjen e veturave. Tash, sipas këtyre dokumenteve që mua m'i kanë dhënë zyrtarisht këtu në Kuvend –

edhe ti i ke, z.Halimi, pasi më pyete – unë vij deri te konkluzioni që Komuna e Dragashit, Drejtorati i Shëndetësisë, posedon 5 vetura të Ndhmës së Parë. 3 vetura viti i prodhimit 2021, dhe 2 vetura viti i prodhimit 2022. Tash unë, për hir të qytetarit, lypj me i pa qato veturat edhe fizikisht. A janë blerë, ku janë blerë, a janë të pajisura qysh është e shkruar në Raport të drejtorit, edhe ku funksionojnë ato veturat? Ju faleminderit!

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Pasi jemi në pikën eventuale, kryetar, një shqetësim është për ju, nga banorët e fshatit Shajne, Xërxe, po edhe Pllajnik. Qe dy-tri vite, rruga për në fshatin Shajne gjatë sezonit veror është njëdrejtimshe, që e shfrytëzon Komuna e Dragashit. Dragash-Shajne, që dalin për me shkue në Opojë, e keni bo rrugë njëdrejtimshe. Ata kanë ankesa, që prej te Shajnja për në Dragash, e sidomos për në QKMF, nuk mundin ta shfrytëzojnë atë rrugë, se e keni bo njëdrejtimshe. Më e keqja është që prej te Sociali i vjetër deri te ura bëhet edhe parkimi i veturave për në Shajne. Ata, së paku për raste urgjente, t'u lejohet atyre, prej te ura e Shajnes, së paku deri te Socialna, që të kyçen për në spital, të kenë qasje bare për raste urgjente, se atyre iu duhet, Shajne-Xërxe-Pllajnik, iu duhet me ardhë në Shajne, me kalue te ura, me mbri te ura poshtë, nëpër Dragash me ardhë, po kalojnë shumë kohë. Herave tjera ke thënë që pasi kemi marrë vendim, keni bo ankesa. Këtë herë i kemi bo ankesat me kohë, që ta keni parasysh, se jeni kryetar edhe i atyre qytetarëve. Ta keni parasysh, me një vendim të policisë apo të drejtorisë tuaj, që prej te Shajnja, së paku te kjo rruga këtu që të kenë kyçje, për ato fshatra një vendim që të kenë kyçje për në spital. Thashë edhe një herë, atyre iu duhet me shkue te ura, me dalë poshtë, me u kthye nëpër Dragash, kolonë e madhe, kohë e gjatë. Së paku për raste urgjente të kenë kyçje në këtë rrugën, dhe prej te Socialna e vjetër e deri te ura të mos ketë parkime të veturave. Ju duhet të bëni zgjidhje edhe keni bo zgjidhje për këtë parkimin qetu që kemi votue, atëherë t'u lehtësohet qytetarëve të Komunës së Dragashit, Shajne-Xërxe-Pllajnik, t'u lejohet kyçja për në spital me një vendim të juajin. Faleminderit!

Agron Gashi: Së pari ju përshëndes të pranishëm! Përshëndetje kryetar, znj.kryesuese dhe ju të gjithë kolegë asambleistë! Unë dola në foltore duke iu drejtuar ekzekutivit, kryetarit të Komunës. Disa shqetësime të banorëve të fshatit Brezne që i kanë prekur kohën e fundit. Duke marrë parasysh gjendjen aktuale, migrimin dhe emigrimin e qytetarëve, shumë lagje, shumë fise kanë mbetur pa të rinj. Dhe, mungesa e tyre ka sjellur pengesa në hapjen e varreve, në rastet kur kemi vdekje të

dikujt. Është bërë një problem shqetësues për hapjen e varreve. Ky problem, mendoj se ka prekur edhe fshatrat tjerë, duke marrë parasysh atë që thashë më parë, se mungojnë të rinjtë. Andaj, kërkesa e qytetarëve është që, juve si i parë i kësaj Komune, do të ishte mirë që të tenderoni ndonjë kompani për hapjen e varrezave. Meqenëse, është e ditur dhe participoni dhe rreth ceremonisë së varrimit jepni para. Mirëpo, ato nuk janë të mjaftueshme. Do të ishte mirë që, kur vdekja troket në dimër, në verë dhe çdo kohë, atëherë duke marrë parasysh gjendjen se nuk ka të rinj për të hapur këto varreza, është bërë problem shqetësues. Andaj, jo vetëm për fshatin Brezne, por për Gorë e Opojë, për 35 fshatra që ekzistojnë, të ketë një kompani tenderuese e cila merret ekstra me hapjen e varreve. Ky nuk është mendimi im personal, i gjithë qytetarëve të fshatit, por edhe nga imami i fshatit Brezne. Ndërsa, në pikën e dytë që dua të flas është fshati Plavë. Është mendimi im personal, varrezat e fshatit, në udhëkryqin ku lidh Opojën, Gorën dhe Prizrenin, në zemër të vendit, për mua paksa është shqetësues, sepse e ardhmja duhet të mendojmë diçka më ndryshe. Një zemër e vendit – ne e dimë që varrezat hyjnë në kuadër të kulturës, por ai vendlokacion me qendra tregtare, me VIVA FRESH, me La Ruota, duke marrë parasysh se varrimi i tyre dhe pusetat që janë të hapura në afërsi të tyre, është paksa shqetësuese. Unë po e drejtoj një mesazh, një kërkesë timen – nëse ndihen keq banorët e Plavës, unë do të kërkoj falje prej kësaj foltoreje – por është mendimi im personal që, së bashku me juve kryetar, të vini me një propozim, me një vendlokacion, ku do të jetë më i shëndetshëm edhe për një të ardhme, sepse unë mendoj se ai vend aty është bukur i ngjeshur me pisha. Bëhet ndonjë dom i pleqve në të ardhmen, apo ndonjë spital, apo fusha sportive, apo diçka tjetër, duhet të llogarisim që lokacioni i cili është duke u përdorur për varreza, është një lokacion – në këndvështrimin tim, në perspektivën time të ardhshme, në të ardhmen e këtij vendi, është një vend jo i përshtatshëm. Andaj, kërkoj që të hapen tema diskutimi me Plavën, edhe pse ata e dimë ne fort mirë që e konsiderojnë si vend i tyre, por vendlokacioni për mu është paksa i papërshtatshëm. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Përshëndetje, të dashur të pranishëm! Para nja dy seancave, ma shumë se dy muaj ka që e kam pyet kryetarin për do investime kapitale që janë parapa në planifikim buxhetor për fshatin Blaç. Më ka thënë që ato investime janë veç në tenderim. U bënë më shumë se dy muaj dhe s'ka fillue asnjë punë, edhe s'po shoh ndonjë ndryshim ose përparim në lidhje me planifikimin buxhetor që ka qenë i destinuar për rregullimin e rreugës “Te Ura e Haxhisë”, mandej i parkut “Shkëndija” në rrugën kryesore të fshatit Blaç, edhe të gjitha investimet që janë paraparë për

fshatin Blaç. A kanë fillue, a janë hala në tenderim, a pritet të fillojnë apo pritet t'i bartin për vitin tjetër kalendarik, mbase? Faleminderit, kryetar!

Nexhat Selaj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kolegë, përshëndetje media! Në këtë pikë që do të diskutoj nuk desha të kyçem, por më nxiti njëri nga kolegët parafolës, kur kërkoi nga kryetari që të dijë për rrugën e asfaltuar të Komunës sonë deri më Mavrovë, ku ka arritur. Unë nuk e di ky kolegu a ka qenë pjesëmarrës vitin e kaluar, kur ne katër-pesë seanca kemi diskutue, dhe këtu po besoj se kryetari e shfrytëzoi pak politikën, tregoi se rruga është rregullue me kohë dhe me atë trashësinë 8-10 cm. Por nuk e tregoi edhe një gjë të tillë, se kjo rrugë është shtrurë në dhjetor – më 20 dhjetor – Është hekur bora dhe është shtrurë asfalti në temperaturën -7 gradë celsius. Këtë, nëse nuk e ke ditë koleg, po të tregoj edhe këtë. Sa i përket kërkesës së Pajtesës, po më vjen mirë se edhe Pajtesën e kam krahu dhe dy vetë, dy asambleista mos po nxjerrim diçka për fshatin Zym. Se po më duket jemi ndër ata fshatra që më pak kemi përfitue nga kjo qeverisje. Për këto katër vitet, sipas disa të dhënave të cilat unë i kam nxjerrë 2021-2022, 2022-2023 e kështu me radhë, janë ndarë dikur rreth 120 mijë euro. Nga këto 120 mijë euro për fshatin Zym, përpos trasimit të rrugës te shkolla drejt fushës, unë nuk e di çka është punue diçka. Pavarësisht, kryetar, se në seancën që shkoi më thajë se nuk ke të drejtë për fshatin Zym – ashtu kam deklarue – pavarësisht a kam të drejtë a s'kam, unë edhe si qytetar i thjeshtë do të kërkoj për të gjitha fshatrat investime. Pajtesa nuk po e di a është në qasje këtu a jo, unë qe katër vite kërkoj që të ketë intervenime në fshatin Zym, pikërisht edhe te kockat, edhe te një kanalizim në pjesën e poshtme të rrugës kryesore, por edhe për rregullimin e kubëve të cilat shkojnë drejt fushës nga shkolla, pasi që aty shihet perspektiva dhe aty hapen edhe krijohen edhe vendet e punës, edhe jepet mundësi për rregullimin e objekteve apo shtëpive që të krijohet vendbanim. Kryetar, tash do të ju drejtohem juve posaqërisht. Po më duket se kjo shkollë e mesme e lartë “Ruzhdi Berisha” shumë bre është lënë jashtë dore. Që në mandat kur ke ardhë, ke thënë se aneksin, punimet, do të shtohet kapaciteti. I keni ndërtue qatë nja katër shtylla edhe me qato kemi mbetur, do të bëhet sivjet, do të bëhet në mot, do të përfundojë, nuk do të përfundojë, mandati po kryhet, ajo ka mbet ashtu. A ka ndërmend të punohet diçka këtë kohën e mandatit apo jo? Gjithsaherë kur kam folë për stadionin e Plavës, ke thënë se është projekt dyvjeçar, unë e kam kuptue edhe e kuptoj çka do të thotë projekt dyvjeçar, por kaloi 2022, kaloi 2023, kaloi edhe 2024, përpos shkatërrimit unë nuk po shoh se çka ka diçka

tjetër aty. Tash, edhe banorët, por edhe ne po kërkojmë këto investime që të kthehen dhe të kryhen në këto fshatra. Faleminderit!

Driton Ademi: Atëherë, unë e kam një pyetje për kryetarin. Kryetar, e pashë që në faqe e keni publiku Kalendarin e dëgjimeve buxhetore për KAB, ku te pika e parë e keni Dëgjimin buxhetor me kryetar të këshillave të fshatrave, OJQ dhe biznese. Deshta me e ditë, kam edhe kërkesë edhe prej disa kryetarëve të fshatrave, a ka fillue pagesa e këtyre kryetarëve të fshatit, pasi që kam qenë edhe anëtar i Komisionit për përzgjedhjen kryetarëve të fshatrave, a ka fillue pagesa e këtyre kryetarëve, se me sa po shihet, edhe dëgjimet buxhetore të viteve të kaluara, nuk i ke pas bon vaki ndoshta as 30% të kryetarëve të fshatrave, nuk kanë marrë pjesë në takime. Është mirë me dalë me e dhënë një opinion të juajin, a ka fillue pagesa e tyre a jo? Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Atëherë, të nderuar delegatë, unë do të filloj me rend të ju përgjigjem pyetjeve. Sa u përket investimeve në fshatin Buqe – ndriçimi publik dhe ndërrimi i kubëzave të vjetra – unë mendoj që këtë vit do të investohet në Buqe, sa i përket edhe kanalizimit edhe kubëzave, ka buxhet të ndarë edhe për këtë vit. Ndërsa, sa i përket ndriçimit publik, në buxhetin e këtij viti ne, edhe pse nga ju ka ardhë kërkesa, ne e kemi parapara që ta bëjmë ndriçimin publik në fshatin Buqe në vitin 2026. Në buxhetin e këtij viti do ta miratojmë buxhetin e mjaftueshëm – nuk është i mjaftueshëm 10 mijë euro vetëm me i nda, sepse nuk mujm me bo kurgjo, por vetëm do të konsultohemi me qytetarët, a do ta bëjmë ndriçimin publik me energji elektrike, apo do ta bëjmë me solarë. Do ta marrim mendimin prej qytetarëve. Sa i përket komisionit për automjetet, ju siç e dini, ju qe nje kohë të gjatë jeni duke u marrë, prej se jam bo unë kryetar, me çështjen e automjeteve të QKMF-së. Ne vitin e kaluar deshtëm të ju përgjigjemi kërkesës suaj, me dalë e me i pa këto automjete. Në momentin ne kur ishim gati me i pa, ju refuzuat me dalë e me i pa, ju atë e keni quajt si defile. Ajo nuk ka qenë defile, por automjetet kanë qenë të renditura njëra pas tjetrës, dhe Asambleja Komunale është ftuar nga kryesuesja me dalë e me i pa këto automjete, ju atë e keni refuzue. Në seancën e kaluar prapë ju keni lyp një komision për me e verifikue këtë. Unë si kryetar, ti e din që kam qenë pro formimit të atij komisioni, sepse e kam ditë që ju nuk do të ndaleni, deri në përfundim të mandatit ti ke me u marrë me këtë temë. Edhe pse Asambleja Komunale e ka thënë mendimin e vet edhe ka votue për këtë komision që nuk është i arsyeshëm, nuk ka nevojë, ju prapë në këtë Asamble e keni çelë këtë problem. Unë do të konsultohem me drejtorin e Shëndetësisë, edhe

personalisht do të merrem me këtë çështje. Por unë e di, ashtu si e kam thënë herën e kaluar, që në mandatin tim sa jam kryetar, ne i kemi blerë dy automjete të reja, edhe një automjet e kemi marrë dhuratë nga Ministria e Shëndetësisë. Po megjithatë, unë do të merrem personalisht me këtë, do të konsultohem me ju, edhe ndoshta do të shkojmë bashkë në QKMF, do t'i shohim edhe nëse ka nevojë – edhe pse Asambleja një herë ka prurë vendim për mos me bo komision – do të shohim mundësinë edhe një herë me e shqyrtue këtë çështjen tuaj. Sa i përket Rrugës Unazore, e di që ka ankesa, sidomos nga qytetarët e fshatit Shajne, por megjithatë, unë mendoj që koha prej tri javësh nuk do të jetë pengesë për qytetarët që ta realizojnë të drejtën e qarkullimit të lirë. Por megjithatë prapë, unë si kryetar i Komunës so të angazhohem që sa më pak pengesa të ketë këtë vit, sa i përket qarkullimit të Rrugës Unazore. Do ta kem një bashkëpunim shumë më të mirë me policinë. Do të kujdesemi që Ura e Shajnes mos të bllokohet, të mos parkohen automjetet në atë drejtim, do ta kem një bashkëpunim shumë më të madh me Policinë e Komunës së Dragashit. Sa i përket hapjes së varrezave, e di që është shqetësuese jo vetëm për fshatin tuaj, por edhe në disa fshatra tjerë mungesa e të rinjve, e njerëzve për hapjen e varrezave, mirëpo në këtë vit e kemi nënshkruar kontratën me Këshillin e Bashkësisë Islame, i kemi ndarë mjetet, edhe pse ju siç e dini ne e kemi rritur shumë e mjeteve, është mbi 200 euro për person të vdekur, por megjithatë këto nuk e di a do të mjaftojnë për hapjen e varrezave. Por, këtë vit nuk mund të bëjmë asgjë. Të shohim vitin e ardhshëm çka mund të bëjmë në këtë drejtim. Është pak e vështirë sepse duhet të gjejmë një kompani të specializuar e cila do të merret me hapjen e varrezave, siç e bën Prizreni. Për momentin këso kompanie ende nuk ka në Komunën tonë, ajo sigurisht mund të themelohet. Por, do të shqyrtohet mundësi e hapjes së një tenderi për hapjen e varrezave për qytetarët e Komunës sonë. Ta shohim a do të ketë kompani të interesuara që do ta bëjnë një gjë të tillë. Sa u përket varrezave të fshatit Pllavë, nuk kam përgjigje. Nuk jam i përgatitur për këtë temë me diskutue, por e di që varrezat e fshatit Pllavë janë vazhdim i varrezave të vjetra, vetëm që i ndan rruga, është e njëjta parcelë. Por unë për këtë çështje për momentin nuk muj me të thënë asgjë. Sa u përket investimeve në fshatin Blaç, unë e di që dia punime kanë fillue, disa janë përfundue. Sot hapet tenderi edhe për një punim tjetër në fshatin tuaj. Besoj që brenda muajit do të fillojnë të gjitha punimet të cilat kanë qenë të planifikuara në fshatin Blaç. Sa i përket rrugës për në Strazimir, ju e dini që ne e kemi përfunduar atë rrugë. Nuk e kam përfundue vetëm unë, unë e kam bo atë pjesën që ka mbet pa përfundue, vërtet jo unë por Qeveria Komunale. Edhe pse ju keni vërejtje që një pjesë e rrugës është shtrurë në një periudhë kur ka qenë dimër, megjithatë, në atë pjesën ku është shtrurë rruga, në

atë kohë kur është shtrur asfalti ka qenë temperatura +15 gradë, edhe kualiteti i asfaltit është shumë i mirë. Nuk ka dëmtime të asfaltit që është shtrur në atë kohë. Sa u përket investimeve në Zym, është investuar në Zym gjatë kohës sa unë jam kryetar: janë bërë trasime të disa rrugëve, janë bërë shumë kubëzime, janë bërë shumë mure mbrojtëse, është ndërtuar ura por ende s'ka përfunduar – kanë mbetur ndoshta edhe 2-3% të punëve pa u përfunduar. Gjithashtu, është investuar edhe në shkollën e fshatit Zym, sigurisht se e dini që kemi investuar deri sa kam qenë unë kryetar. Sa u përket investimeve në Shkollën e Mesme, këtë vit është parashikuar, së shpejti do të shpallet tenderi për ndërtimin e atij aneksit të cilin nuk kemi mundur ta bëjmë para dy viteve. Gjithashtu, aty jemi duke investuar në ndërtimin e kabineteve të ndryshme, për ngritjen e cilësisë së mësimin. Sa i përket stadionit të Pllavës, është problem, e kam diskutuar këtë edhe me qytetarët. Por, ne do të merremi me këtë çështje edhe sigurisht që do ta përfundojmë. Së shpejti do të shpallet tenderi për vazhdimin e punimeve në këtë stadion. Kemi bërë edhe një kërkesë, kam qenë unë në një takim në MKRS, kam marrë premtje që edhe MKRS do të marrë pjesë në ndërtimin e këtij stadioni. Gjithashtu, ne kemi paraparë mjete për këtë vit që të punohet me stadionin dhe do të shohim edhe mjete tjera në buxhetin e vitit të ardhshëm, që këtë stadion ta përfundojmë. Sa i përket Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, është bërë ai kalendari, ndërsa pagesën e kryetarëve të fshatrave nuk e kemi filluar edhe nuk kemi bërë deri më tash asnjë pagesë.

Nexhat Selaj: Kryetar, shtrimi i rrugës për Strazimir është bërë më 20 dhjetor të vitit që shkoi. Nëse në 20 dhjetor temperaturat janë 15 gradë celsius në lartësinë mbidetare 2000 m, më fal, unë nuk jam mirë. Kryetar, 20 dhjetor, kompania Renelual Tahiri ka pastruar borën, edhe masi është pastruar bora, aty e keni gjujt asfaltin edhe është bërë trasimi. Për kualitetin, nuk jam ekspert, nuk e di, por për këtë jam shumë i sigurt. Investimet në fshatin Zym, shkollën mos e llogarit se shkolla është bërë nga Fondacioni i ndihmave, kështu që hiq nga investimet. Investimet në shkollë, te ajo klasa që është ndarë, unë kam biseduar edhe me drejtorin e Financave, e di shumë mirë atë. Ndërsa, sa i përket edhe mureve të shumta që po më thuash janë bërë, unë nuk po e di ku është bërë. Në Qollopek po, që akoma nuk është krye – po besoj që kryhet se mbi 90% e punimeve janë krye. Por, në fshatin Zym unë nuk e di ku ka mure edhe sa janë, se vlera është 120 mijë euro, kryetar. Nëse është një vlerë e vogël, intervenim i vogël, nuk po hi me folë ma tepër. Nëse ka kubëzime private, edhe private në fshatin Zym s'ka. Seriozisht na ke anashkaluar. Bare private të kishe shtrur, nuk po hy tash me e cek çka është duke u bërë me kubëzimet private të tjera, në fund të fundit po

shtrahet për qytetarët edhe krejt është okej. A është e drejtë a s'është e drejtë, i takon prokurorisë, le të merret me to. Bare private! As private, as ato të cilat na takojnë nuk i kemi.

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit znj. Kryesuese. Z. Kryetar, pak më parë thatë se gjatë mandatit tuaj janë blerë vetëm dy automjete, edhe atë për vitin 2022. Nuk e di gjithashtu nëse jeni të vetëdijshëm se ju trashëgoni pasurinë komunale edhe nga pushteti i kaluar, dhe se keni obligim të kujdeseni për të. Dua të theksoj se drejtori juaj i Shëndetësisë, i cili ka tetë vite që është drejtor, në kohën kur ju dhe Shaban Shabani “garonit” me diasporën se kush do të bëhej kryetar komune, ka blerë automjete të ndihmës së shpejtë. Tani, ajo që më intereson mua është të shihet gjendja e atyre pesë automjeteve si pasuri e komunës – pavarësisht nëse janë blerë në mandatin tuaj apo jo. A pajtoheni me mua se ju e keni trashëguar edhe pasurinë e pushtetit të kaluar? Kujtohuni që këtu kemi diskutuar edhe për atë xhipin Mitsubishi, kur z.Samidin pyeti se çfarë ishte “dudo”. Dhe një gjë tjetër, është turp që asamblistët e këtij Kuvendi të dërgohen në shtëpi me vetura zyrtare. Ashtu ka bërë zotëria juaj para dy seancave dhe dyshoj që edhe sot e ka bërë, që të mos kemi kuorum.

Artan Loshaj: Shumë shkurt, kryetar. Na kanë dëguar qytetarët dhe shpresojmë në këtë përgjigjen tënde, që do të bëni zgjidhje dhe do ta lehtësoni këtë Rrugë Unazore për qytetarët e fshatit Shajne, Xërxe dhe Pllajnik. Po masi jemi këtu, e hapet diskutimin për te stadioni i Pllavës. Po due me e bo një pyetje. Stadiumi i Blaçit, para tri viteve, 50 mijë euro urgjent i kemi dhënë. Ku ka mbet ai stadium, a do të bëhet. Edhe zhveshtorja në stadionin e qytetit. Qe katër vite jeni kryetar, edhe për këtë, se bajagi – prom të kam dëgjue në 2021-tën, kur ke qenë në debat me kandidatin e PDK-së, na ke akuzue që po bëjmë fushatë për zgjedhje. Të shohim ku kemi mbet me këto dy: zhveshtoren e stadiumit edhe me stadiumin e fshatit Blaç që i kemi dhënë urgjentisht 50 mijë euro. Faleminderit!

Uran Halimi: Mu po më vjen mirë, kryetar, që sa herë po e ngre si çështje, ka me dalë në tender, ka me dalë tenderi. Po pres sot a po del në tender diçka. Nashta në tender del, qytetarët nuk e shohin atë pjesën e tenderit, po kam me e kqyr kismet. Qytetarit i intereson konkrete çka është diçka, se përveç do kubëzimeve, oborreve edhe disa nderimeve të shokëve, unë s'po shoh në Blaç. Te stadioni, që th Artan Loshaj, është ndreq edhe është bo pistë për trika me makina aty, krejt rinia

shkojnë edhe bëjnë xhiro me kerra në atë stadion. Edhe pse rrethojat i kanë gjysmë të rrënuara – kryetarit i kemi thënë, edhe Nedžmidini në një kohë e ka përmend këtë pjesën – mirëpo, qaq me urgjencë është konë, e qaq është neglizhues ajo puna e stadiumit, sa që s’e di a ia vlen edhe me diskutue. Kryetar, unë po pres që projektet të cilat kanë qenë të parapra në planifikim buxhetor, të fillojnë. Tash nuk kemi edhe shumë kohë, se ne e dimë që verën e kemi goxha të shkurtë e na zë dimri shumë shpejt. Por, të paktën me fillue këto projekte, që me i dhënë shpresë qytetarit, se duhet me dalë me lyp vota prapë.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Deshta me u ndërlidh me diskutuesit, por për fat të keq, ne të njëjtat çështje po i trajtojmë, edhe opinionit nuk e di realitetin – një pjesë, se shumica e dinë – po mund edhe të manipulohen me propaganda e me rrena. Tash po na vjen mandati edhe neve edhe kryetarit, bashkë me ne, edhe do të ketë zgjedhje. Çka kemi pa na, kryetari i ka bo dy punë, edhe dy faje i ka: që jau ka ndalë taxhinë matrapazave, dhe ka punue ma shumë se ata tjerët për katër-pesë mandate çka kanë qenë. Tash, a i konvenon dikujt a nuk i konvenon, ky është realiteti. Njerëzit e ndershëm nuk janë matrapazë. Krejt opinionit këtë e di. Po më vjen keq që po dilet në debat – nuk më takon mu me dalë me e mbrojt askënd, e aq më pak kryetarin. Por, në opinion kur të dilet me këso diskutime, ata nuk e dinë realitetin edhe punën çka është bërë, se shembull ai nuk ka qenë as në Brezne, as në Buqe, as në Pllavë, as në Bresanë, ose diku tjetër, ose në Strazimir. Sa i përket QKMF-së, ne jemi dëshmitarë vetë, personi që ka folë – nuk po ia përmendi emrin – ai nuk është profesionist. Kryetari është akademik i shkencave të mjekësisë. Dhe, furnizimet, edhe punëtorët që punojnë, edhe ata të cilët janë kundërshtarët më të mëdhenj të politikës, e pranojnë po nuk dojnë ta shprehin, se QKMF-ja edhe Shendetësia kurrë nuk kanë qenë ma mirë. Kurrë nuk kanë qenë më të furnizuara. Kurrë nuk ka pas shërbime më kualitative, si në Emergjencë, si me kerra, si në shërbime në shëndetësi, dhe çdo çështje adresohet. Po më vjen keq, për shembull, që unë si punëtor, ndoshta edhe më i vjetër jam, që në vend se t’i ngremë çështjet për të cilat duhet me punue – QKMF është, besoni, edhe e dinë edhe kolegët, që me Ndhmën e Shpejtë është e pajisur si në perëndim. Shkoni në perëndim, kqyrni kerrat e Ndhmës së Shpejtë, Emergjencën, edhe shërbimet tjera, a kana dallim. Tjetër është që ne nuk kemi, për shembull, përveç Listës esenciale, që s’kemi barna edhe s’kemi të drejtë me pas mundësi më tepër. Edhe një çështje deshta me e ngrit. Ne si Asamble kemi pru vendime, ne e mbikëqyrim Hidroregjionin dhe ne i votojmë kur ata na bien kërkesat për çmime. Punëtorët, inkasantët po bëjnë

propagandë se Asambleja Komunale i ka pru këto vendime për të cilat i tatimojnë, ndoshta edhe në mënyrë të padrejtë. Nuk është i barabartë një arxhendar me një biznes të suksesshëm, dhe tatimohet ndoshta i barabartë arxhendari që nuk hedh mbeturina njëjtë me ndonjë biznes që bën edhe mbeturina të mjaftueshme, me shumicë. Ju ta dini të gjithë, jemi të barabartë, se Asambleja Komunale e ka pru kërkesën që e ka bo rritjen e pagesës. Dhe aty pak na kanë pre në besë – po më vjen keq – ne e kemi pru prej 1 janarit, e ata e kanë rrit menjëherë. Le ta dijë opinioni që ne nuk e kemi pru vendimin me e rrit menjëherë, po prej 1 janarit 2025, ata ia kanë qit qytetarëve rritjen dhe ne e kemi pague. Le të kenë kujdes, mos të bëjnë këso gjëra, me u arsyetue për gabimet që i bëjnë vetë. Se Asambleja e ka shabllonin, e kanë rrit çmimin për 1 euro për ekonomitë familjare. Jo në atë formën qysh ata po e paraqesin, se ka dikush që po tatimohet në mënyrë të padrejtë. Kryetar, këtë duhet me e pas parasysh. Ne e kemi rrit me përqindje, e dish ti mirë qysh e kemi diskutue. Ti ke ngrit çështje. E kem votue bashkë ti me mu. Asambleja është një.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! E mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancën e radhës!